



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:013984

Datë: 12.08.2024

Numri i dokumentit: 06039432

PKR.nr.17/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË /DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, në përbërje nga trupi gjykues prej tre gjyqtarëve profesionistë, përkatësisht gjyqtari Naser Foniqi – kryetar i trupit gjykues -KTGJ dhe gjyqtarët Fatime Dërmaku e Ertan Sejfulla, anëtarë të trupit gjykues - ATGJ, me zyrtaren ligjore Ibadete Zullufi, në çështjen penale të akuzuarit F.M., i akuzuar për shkak të veprave penale Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378, par. 5, lidhur me par. 1 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës – në vijim KPRK dhe Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378, par. 4, lidhur me par. 1 të KPRK, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda PP.I.nr.132/2019, të datës 31.01.2020, pas shqyrtimit fillestar të datave 04.01.2024 dhe 22.03.2024 dhe atij gjyqësor, të hapur për publikun, të mbajtur me datat 01.08.2024 dhe 06.08.2024, në të cilin kanë qenë të pranishëm: prokuroret e shtetit Javorka Prlincevic e Dulina Hamiti, të dëmtuarit B.K. e B.M., i akuzuari F.M., me mbrojtësin e tij av. Fitim Gashi, me autorizim, përkthyesi i gjuhës angleze A.S. dhe përkthyesit e gjykatës B.K.1. e A.B., pas shqyrtimit gjyqësor, me datë 06.08.2024 mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari F.M., i biri i H. dhe Sh., e vajzërisë B., i lindur me datë ..., në Londër/Britani e Madhe, rruga ..., numër ..., ndërsa në Kosovë me banim në fshatin G., Komuna Fushë Kosovë, me numër personal ..., ka të kryer shkollën profesionale, i martuar, – babë i një fëmije, i punësuar – realizon të hyra mujore në shumë prej ... funta, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar – shtetas i Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe.

ËSHTË FAJTOR

I. S e p s e: me datë 24.07.2018 rreth orës 14:50, në rrugën lokale Glllogoc-Sllatinë, në fshatin ..., Komuna Fushë Kosovë, deri sa ka drejtuar automjetin e markës “Toyota Aygo”, me targë ..., me shpejtësi prej rreth 90 km/h, në vendin ku shpejtësia maksimale e lejuar ka qenë 50 km/h, si rrjedhojë e tejkalimit të shpejtësisë dhe pa përvojë për të drejtuar automjetin, pa patentë shofer, ka humbur kontrollin mbi automjetin, ashtu që, duke u bartur ka dalë jashtë rrugës, me ç’rast, me pjesën e anës së djathtë ka goditur këmbësorin- tani të ndjerin F.K., i cili në atë moment ka qenë duke lëvizur në trotuar në anën e majtë e nga goditja e pësuar është hedhur rreth 35metra larg, ndërsa automjeti ka vazhduar duke e goditur shtyllën elektrike e më pas është ndaluar në murin e një shtëpie të pa banuar. Si pasojë e këtij aksidenti, këmbësori-tani i ndjeri F.K. ka vdekur në Qendrën Emergjente në Prishtinë

në ora 15:43, të të njëjtës ditë, ndërsa vdekja ka ardhur si rrjedhojë e gjakderdhjes në kokë në hapësirën e kraharorit dhe të barkut- abdomenti, e të cilat sipas ekspertit mjeko ligjor janë shkaktuar me veprimin mekanik të mjetit të fortë mbretës (jo i mprehtë, i topitur), sipas raportit të autopsisë MA 18211 i datës 25.07.2018, ndërsa vetë i akuzuari ka pësuar lëndime të rënda trupore, si dhe ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm material në shtyllën elektrike dhe pronën e J.K.,-

- me këto veprime, ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378, par. 5, lidhur me par. 1 të KPRK, dhe

II. S e p s e: me datë, kohë dhe vend si në pikën I të dispozitivit të aktakuzës, në automjetin të cilin e ka drejtuar tani i akuzuari në vendin e pasagjerit, pranë ngasësit ka qenë edhe tani i dëmtuari B.M., i cili si pasojë e veprimeve me automjet nga tani i akuzuari ka pësuar lëndime të rënda trupore në formë të thyerjes së kockës së brinjëve në anën e djathtë të kafazit të kraharorit, thyerje të zgjatimit anësor të unazave të anës së djathtë të boshtit kurrizor me gjakderdhje në regjionin ballor të anës së majtë të trurit, të cilat sipas ekspertit mjeko ligjor janë shkaktuar me veprimin mekanik të mjetit të fortë mbretës (jo i mprehtë, i topitur),-

- me këto veprime, ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378, par. 4, lidhur me par. 1 të KPRK.

Prandaj, në bazë të neneve: 41; 45; 73; 378, par. 5, lidhur me par. 1 të KPRK; 378, par. 4, lidhur me par. 1 të KPRK, si dhe nenit 364, par. 1 të Kodit nr. 08/L-032 të Procedurës Penale – në vijim KPP, të akuzuarit F.M., i shqipton:

DËNIM ME BURGIM

- **në kohëzgjatje prej tri (3) vite**, për veprën penale si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe
- **në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj**, për veprën penale si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, i cili dënim me pëlqimin e të dënuarit i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 3000 euro.
- Dënimin me gjobë si më lart, i akuzuari mund ta paguaj deri në tre këste.
- Dënimet si më lart do të ekzekutohen brenda afatit prej 15 ditësh por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të merr formën prerë.
- Detyrohet i akuzuarit që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale aq sa dalin sipas regjistrit të shpenzimeve, për ekspertizën e komunikacionit të paguaj 40.88 €, për ekspertizën mjeko ligjore të paguaj 20.00 €, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor duhet të paguaj shumën prej 100.00 € dhe 50.00 € në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimet, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej njëqind (100) €, njëzet (20) euro për ekspertizën mjeko ligjore dhe pesëdhjetë (50) € për Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimet, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- **Të dëmtuarit B. (J.)K.**, me banim në Prishtinë, lagja Dardania, rr. "...", hyrja ..., kati ..., nr. ... dhe **B.(S.)M.**, nga fshati ..., Komuna Fushë Kosovë, për realizimin e kërkesës

pasurore-juridike nuk udhëzohen në kontest civil sepse gjatë shqyrtimit gjyqësor kanë heqë dorë nga kjo e drejtë.

ARSYETIMI

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.132/2019, të datës 31.01.2020, për shkak të dyshimit të bazuar se i akuzuari F.M., ka kryer veprat penale Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378, par. 5, lidhur me par. 1 të KPRK dhe Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378, par. 4, lidhur me par. 1 të KPRK.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 04.01.2024 dhe në atë të shqyrtimit gjyqësor të datës 22.03.2024, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i akuzuari F.M. ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe është deklaruar i pafajshëm për veprat penale për të cilat është akuzuar, duke theksuar se i pranon veprimet por jo edhe veprat penale.

Në fjalën hyrëse, prokurori i shtetit ka thënë se prokuroria ka siguruar prova të mjaftueshme që i akuzuari ka kryer veprat penale ashtu siç është përshkuara në dispozitivin e kauzës,. Provat të cilat janë siguruar dehe mbledhur gjatë procedurës së hetimeve e të cilat janë propozuara edhe për administrim në mënyrë të padyshimtë do ta vërtetojnë që i akuzuari i ka kryer veprat e cekura penale. Provat materiale të propozuara në aktakuzës do të administrohen gjatë shqyrtimit gjyqësor e të cilat do ta vërtetojnë dyshimin e prokurorisë.

Ndërsa, në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit ka thënë se pas përfundimit të procedurës së provave në analizimin dhe vlerësimin e provave, si dhe provave të cilat mbrojtja i ka propozuar dhe dorëzuar, ekspertizën e ekspertit N.D. të datës ..., në mënyrë të pa kontestuar është vërtetuar që i akuzuari ka kryer veprat penale të cilat janë lëndë e aktakuzës PP.I.nr 132/19, në mënyrën siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës pikat I dhe II, duke shtuar se pretendimet e mbrojtjes dhe kërkesat për rikualifikimin e veprave penale nuk qëndrojnë assesi, sepse i akuzuari në mënyrë të vetëdijshme, duke ditur që nuk posedon patentë shofer dhe i vetëdijshëm që me veprimet e tij mund të rrezikoj jetën e dikujt, është ulur dhe ka vozitur veturën gjë që me ligj nuk ka pasur të drejtë, pasi ka qenë i vetëdijshëm që po e shkel ligjin duke drejtuar pa patentë shofer, pastaj në kundërshtim me rregullat e trafikut në pjesën e rrugës ku shpejtësia e lejuar është 50 km/h, i akuzuari ka vozitur veturën me shpejtësi përafërsisht të dyfishtë se sa është e lejuar, përkatësisht 90 + - 5 km/h, dhe përsëri i ka shkelur rregullat e komunikacionit dhe si pikë e 3, gabimi katastrofal që e përshkruan si mbrojtje ai thotë se autobusi ka qenë duke u ndalur, e nëse autobusi ka qenë në proces të ndaljes do të thotë se ka ekzistuar mundësia që dikush nga udhëtarët të dal nga autobusi dhe i akuzuari me veprimet e tij ka mundur t'i rrezikoj edhe udhëtarët që kanë dalë nga autobusi. Pastaj, prokurori i shtetit ka theksuar se veprimet tjera të akuzuarit janë të përshkuara shumë mirë, por këto tri veprime janë ato që kanë sjellë deri te shkaktimi i aksidentit me fatalitet, duke shtuar se asnjëherë nuk mund të thuhet që aksidenti ka ndodhur nga pakujdesia pasi që i akuzuari me vetëdije e ka ditur që duke ndenjur në veturë e shkel ligjin dhe pasojat e tij mund të shkaktojnë pasojat që kanë ndodhur, andaj i ka propozuar gjykatës që duke i vlerësuar provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, pranimin e të akuzuarit dhe të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, me dënim adekuat i cili do të ndikoj jo vetëm te i akuzuari por edhe te pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, pasi jemi dëshmitarë që për shkak të bindjes së lehtë se nuk do të ndodhë asgjë çdo ditë nëpër rrugë humbin jetë njerëzish.

I dëmtuari B.K., në fjalën hyrëse ka thënë se e mbështet fjalën hyrëse të prokurorit të shtetit, derisa si familje ndihen të dëmtuar por nga i akuzuari nuk kërkojnë kompensim dëmi sepse këtë dëm e kanë kompensuar nga Kompania e Sigurimit ku ka qenë e siguruar vetura me të cilën është kryer vepra penale.

Në fjalën e tij hyrëse, mbrojtësi i të akuzuarit av. Fitim Gashi ka deklaruar se e ka kundërshtuar aktakuzën jo për nga përmbajtja por nga cilësimi i veprës, për faktin se ka konsideruar se kualifikimi duhet të përmbaj edhe paragrafin 6 të nenit 378 të KPRK, pasi sipas tij vepra penale nga i mbrojturi i tij është kryer nga pakujdesia, dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor do të vërtetohet fakti se i mbrojturi i tij në rastin e kryerjes së veprës penale ka qenë në pakujdesi dhe se pretendimi i prokurorisë se i njëjti nuk ka poseduar patentë shofer nuk tregon që vepra nuk është kryer nga pakujdesia. Po ashtu, mbrojtësi ka thënë se nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës do të vërtetohet se mënyra se si ka ardhur deri te aksidenti ka qenë krejtësisht e paqëllimshme, duke shtuar se ka angazhuar një ekspert të pavarur i cili e ka përgatitur një ekspertizë me të cilën do të vërtetohet se në këtë aksident kanë kontribuar edhe faktorët tjerë që kanë shpjer deri të humbja e kontrollit të automjetit nga i mbrojturi i tij, e pastaj shkaktimi i aksidentit, duke shtuar se gjatë gjithë fazave të procedurës, i mbrojturi i tij ka qenë dhe është akoma i gatshëm për pranimin e fajësisë, pasi që i njëjti është ndjerë dhe vazhdon të ndihet shumë keq për rastin e që një pranim i tillë po pengohet nga prokuroria për shkak që pranimi i tillë nuk përmban paragrafin 6.

Ndërsa, në fjalën përfundimtare të përgatitur me shkrim mbrojtësi Gashi ka thënë se gjatë shqyrtimit gjyqësor me asnjë provë relevante nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij ka kryer veprat penale si në aktakuzë, duke shtuar se nga fillimi i kësaj procedure as ai e as i mbrojturi i tij nuk e kanë mohuar se i mbrojturi i tij ka kryer veprat penale nga pakujdesia, e jo sipas pretendimit të aktakuzës. Pastaj mbrojtësi ka theksuar se nga deklarata e të dëmtuarave B.K. dhe B.M. është vërtetuar se familjet e tyre nuk kanë pasur ndonjë mosmarrëveshje me tani të akuzuarin, përkatësisht i dëmtuari M. dhe i akuzuari janë familjarë, janë djemtë e dy vëllezërve dhe raportet mes tyre janë jashtëzakonisht të mira. Ndërsa me familjen e të dëmtuarit B. janë pajtuar gjatë ceremonisë së ngushëllimeve, e deri te pajtimi ka ardhur ngase kanë ardhur në përfundimin se aksidenti nuk ka qenë i qëllimshëm. Sipas mbrojtësit, i mbrojturi i tij ka qenë duke drejtuar veturën me shpejtësi deri 50 km/h dhe me gjatë tejkalimit të autobusit ka humbur kontrollin, ka kaluar në trotuar dhe duke u mundur që të mos e godas tani të ndjerin ka goditur në fillim shtyllën elektrike e pastaj me derën e pasagjerit ka goditur tani të ndjerin, duke theksuar se edhe autobusi ka dhënë një kontribut indirekt në shkaktimin e aksidentit, pasi i njëjti ishte ndalur papritur dhe në vendin joadekuat për ndalim të autobusëve. Po ashtu mbrojtësi ka thënë se sipas ekspertizës nga eksperti i pavarur N.D., i pandehuri është mundur që të ndalet dhe të shmang aksidentin, duke theksuar se vepra penale është kryer nga pakujdesia dhe se të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor shkojnë për tej dyshimit të bazuar mirë se i mbrojturi i tij ka vepruar me pakujdesi të vetëdijshme, pastaj mbrojtësi i ka propozuar gjykatës që ta ndryshoj cilësimin juridik sipas qëndrimit të mbrojtjes që nën kupton se aksidenti është kryer nga pakujdesia, ndërsa lidhur me sanksionin penal, beson se gjykata ka vend që ta zbus dënimin pasi ndikojnë shumë rrethana siç janë: deklarimi i palëve të dëmtuara se janë pajtuar me të akuzuarin dhe familjen e tij, moshë e re e të akuzuarit në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë vetëm 19 vjeç, në rastin e aksidentit ka pësuar edhe vet lëndime të rënda trupore, ka bashkëpunuar me organet e drejtësisë, çdo herë ka qenë dhe është i gatshëm ti përgjigjet ftesave të organeve të drejtësisë, i njëjti është baba i një fëmije të sapolindur dhe veprat penale kanë ndikuar shumë në jetën e tij personale dhe në gjendjen shëndetësore psikike, duke shtuar se në momentin e kryerjes së veprës penale i mbrojturi i tij ka qenë në procedurë për patentë shofer në Angli, ku e kishte përfunduar tekstin me shkrim dhe ishte në pritje që ti nënshtrohej testit praktik. Në raport me veprën e dytë, mbrojtësi i ka propozuar

gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor, por ta lirojë nga dënimi, pasi që i dëmtuari B.M. është djali i axhës së tij dhe pasoja e kësaj vepre penale e ka goditur tani të akuzuarin dhe familjen e tij.

I akuzuari është pajtuar me fjalën hyrëse të mbrojtësit të tij, ndërsa në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se e ka dëgjuar fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, e njëjta është ajo që edhe ai e mendon, duke shtuar se ndjen keqardhje të tepërt për atë që ka bërë, se e ka thënë edhe më parë e këtë e shpreh prapë, duke pasur parasysh edhe faktin se tani është prind i një fëmije dhe pres edhe fëmijën e dytë.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, janë dëgjuar të dëmtuarit – dëshmitarët: B.K. e B.M., janë administruar provat materiale të propozuara nga prokuroria në aktakuzë dhe është dëgjuar i akuzuari, e të paraqitura si në vijim:

I dëmtuari - dëshmitari B.K., në pyetje nga prokurori i shtetit nën betim është përgjigjur se ditën kur ka ndodhur ngjarja me datë 24.07.2018, ka qenë në Ferizaj duke punuar, përkatësisht nuk ka qenë në shtëpi, e kur ka arritur në Prishtinë rreth orës 18, bashkëshortja e tij e ka njoftuar se ka ndodhur aksidenti në të cilin vëllai i tij F. kishte humbur jetën.

Në pyetje nga mbrojtësi i të akuzuarit, i dëmtuari - dëshmitari B.K. ka thënë se para ngjarjes nuk e ka njohur familjen e të akuzuarit e as të akuzuarin, por babai i tij mund ta ketë njohur familjen e të akuzuarit pasi që janë afër si fshatra dhe se asnjëherë nuk kanë pasur ndonjë mosmarrëveshje me familjen e të akuzuarit e as me të akuzuarin, duke shtuar se pas aksidentit, familjarët e tani të akuzuarit kanë qenë në të pame për ngushëllime dhe gjatë të pamës babai i tij dhe xhaxhallarët e tij janë pajtuar me familjen e tani të akuzuarit, përkatësisht ua kanë falur sipas traditave, pasi që kanë ardhur në përfundimin se aksidenti nuk ka qenë i qëllimshëm.

I akuzuari ka thënë se e di çfarë ka bërë dhe nuk ka pyetje për të dëmtuarin B.K., përveçse i shpreh keqardhje për atë çfarë ka ndodhur.

I dëmtuari - dëshmitari B.M., në pyetje nga prokurori i shtetit nën betim është përgjigjur se ditën kritike kur ka ndodhur aksidenti, kanë qenë në shtëpinë e axhës së tij H., bashkë me tani të akuzuarin F., djalin e H., me të cilin kanë vendosur të hanë bukë, por meqenëse ishin vetëm në shtëpi, kanë vendosur të shkojnë për të blerë ushqim të gatshëm në qebaptore në fshatin B., e për këtë kanë përdoruar veturën e prindit të F. të cilën e ka drejtuar F., për të cilin nuk ka pasur njohuri se nuk ka pasur patentë shofer, duke theksuar se gjatë rrugës mban mend vetëm deri sa F. ka hyrë në tejkalim të autobusit, e më tutje nuk i kujtohet asgjë. Pastaj, I dëmtuari - dëshmitari M. ka thënë se vendi ku është tejkaluar autobusi është vendbanim me shtëpi anash dhe nga shtëpia ku e tyre deri te tejkalimi i autobusit mund të kenë kaluar 5-6 minuta dhe e njëjta mund të jetë 5-6 km largësi.

Në pyetje nga mbrojtësi i të akuzuarit, i dëmtuari - dëshmitari B.M. është përgjigjur se me sa i kujtohet atij, deri sa kanë arritur te autobusi, F. e ka drejtuar veturën normalisht, por gjatë tejkalimit e ka rritur pak shpejtësinë, duke shtuar se ditën kritike ka qenë hera e parë që ai ka qenë në veturë me F. dhe se nga ky aksident ka pësuar lëndime në shpinë dhe pas kokës, ndërsa ka thënë se nuk kërkon që F. të dënohet për lëndimet e shkaktuara ndaj tij.

I akuzuari ka thënë se nuk ka pyetje e as vërejtje në thëniet e të dëmtuarit - dëshmitarit B.M., përveç se i vjen keq për lëndimet që ia ka shkaktuar.

Në pyetje nga KTGJ, i dëmtuari - dëshmitari B.M. ka thënë se për shkak të lëndimeve të pësuar në këtë rast, ka qëndruar në spital, ndërsa F. ka shkuar e ka vizituar dhe është

interesuar për gjendjen e tij shëndetësore, e pas qëndrimit në spital F. gjithmonë ka shprehur keqardhje ndaj tij për këtë rast.

Në pyetje nga ATGJ Ertan Sejfulla, i dëmtuari - dëshmitari B.M. është përgjigjur se atë ditë F. nuk ka konsumuar alkool dhe nuk e di nëse i njëjti konsumon alkool.

- Raporti i vendit të ngjarjes,
- Lista e provave të gjetura në vendin e ngjarjes,
- Foto albumi i datës 24.07.2018,
- CD me video incizimet nga kamerat e sigurisë të KEK-ut
- Raporti i autopsisë i Dr. N.H. MA 18-211 i datës 25.07.2018 i cili përcakton shkakun e vdekjes së tani të ndjerit F.K.t,
- Konstatimi dhe mendimi i ekspertit mjekoligjor dr. F.D. i datës 06.05.2019, me të cilin janë ekspertuar lëndimet e të dëmtuarit B.M.,
- Konstatimi dhe mendimi i ekspertit të komunikacionit Msc. B.I., i datës 19.08.2018, me të cilin në mënyrë profesionale është kryer ekspertiza si e veprimeve të cilat kanë sjellë deri te aksidenti i komunikacionit nga i akuzuari e po ashtu është ekspertuar edhe vendi i ngjarjes dhe është sqaruar se cilat veprime i ka ndërmarrë i akuzuari deri te shkaktimi i aksidentit të komunikacionit, po ashtu edhe vdekjen e të ndjerit F. dhe lëndimet e të dëmtuarit B.M.,
- CD, nga e cila janë shikuar pamjet e ngjarjes së datës 24.07.2018, e në të cilën në pamje shihet një këmbësor duke ecur trotuarit në drejtim të shtëpisë me tulla dhe kulm të kuq, pastaj me shpejtësi dhe në mënyrë të çrregullt vjen vetura e cila shkon drejt shtëpisë si më lart, duke lënë gjurmë të frenimit pas. Në këtë vend ku shihen pamjet ka shtëpi afër rrugës e po ashtu është edhe hyrja e KEK-ut dhe objekti në të cilin shihet roja - sigurimi i KEK-ut, dhe
- Ekspertiza e kryer nga eksperti i komunikacionit rrugor Dr. Sc. N.D. me të cilën për dallim nga ekspertiza e komunikacionit që u administrua më lart, nga e cila vërtetohet fakti se tani i akuzuari ka humbur kontrollin e automjetit, ka dalë në anën e majtë të rrugës ku fillimisht ka goditur shtyllën elektrike dhe në atë moment me pjesën e djathtë të veturës e ka goditur edhe këmbësorin.

Pas konsultimit me mbrojtësin e tij, i akuzuari F.M., ka deklaruar se do ta shfrytëzoj të drejtën e tij për tu përgjigjur dhe në pyetje nga mbrojtësi i tij ka thënë se atë ditë bashkë me tani të dëmtuarin B. kanë vendosur të shkojnë të blejnë bukë, me ç rast kanë hipur në veturë të cilën e ka drejtuar vet, dhe deri sa kanë arritur pas autobusit veturën e ka drejtuar sipas rregullave-shenjave të shpejtësisë, por kur e ka parë autobusin duke u ndaluar ka filluar ta tejkaloj atë dhe ka humbur kontrollin në drejtimin e veturës. Pastaj, i akuzuari ka thënë se nuk ka pasur patentë shofer, por e ka kryer testin e patentë shoferit në kompjuter dhe ka kaluar testin në kompjuter, në procedurën zyrtare të Mbretërisë së Bashkuar për patentë shofer, por nuk është pajisur me patentë shofer, duke shtuar se para kësaj ngjarje nuk e ka drejtuar veturën në Kosovë, por në Angli ka kryer praktikën e vozitjes, duke theksuar se ka qenë duke tejkaluar autobusin dhe është frikësuar se mos po vjen ndonjë veturë nga ana e kundërt

dhe për këtë ka humbur drejtimin, e ky aksident ka ndikuar shumë në jetën e tij meqenëse tani është edhe prind dhe është shumë i penduar për rastin.

Në pyetje të KTGJ, i akuzuari ka thënë se prindi i tij ka qenë në Kosovë kur ka ndodhur ngjarja dhe të njëjtin nuk e ka pyetur për ta marrë dhe drejtuar veturën, ndërsa çelësin e veturës e ka marrë te televizori, aty ku e ka lënë prindi i tij.

Aktgjykimi si më lart është bazuar vetëm në faktet dhe provat e proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor, siç parasheh dispozita e nenit 360 të KPP, e për të cilat do të jepet vlerësimi si në vijim:

Nga dëshmitë e të dëmtuarve – dëshmitarëve B.K. e B.M., provave materiale si më lart të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe nga mbrojtja e tani të akuzuarit, është vërtetuar se me datë 24.07.2018 rreth orës 14:50, në rrugën lokale ..., në fshatin B., Komuna Fushë Kosovë, tani i akuzuari deri sa ka drejtuar automjetin e markës “Toyota Aygo”, me targë ..., me shpejtësi prej rreth 90 km/h, në vendin ku shpejtësia maksimale e lejuar ka qenë 50 km/h, si rrjedhojë e tejkalimit të shpejtësisë dhe pa përvojë për të drejtuar automjetin, pa patentë shofer, ka humbur kontrollin mbi automjetin, ashtu që, duke u bartur ka dalë jashtë rrugës, me ç’rast, me pjesën e anës së djathtë ka goditur këmbësinorin- tani të ndjerin F.K., i cili si pasojë e lëndimeve të pësuar ka vdekur në Qendrën Emergjente në Prishtinë në ora 15:43, të të njëjtës ditë, ndërsa me datë, kohë dhe vend si në pikën I të dispozitivit të aktakuzës, derisa në vendin e pasagjerit ka qenë tani i dëmtuari B.M., i cili si pasojë e veprimeve me automjet nga tani i akuzuari ka pësuar lëndime të rënda trupore.

Nga dëshmia e të dëmtuarit – dëshmitarit B.K., është vërtetuar se nga bashkëshortja e tij është njoftuar se ka ndodhur një aksident në të cilin vëllai i tij F. ka humbur jetën.

Nga dëshmia e të dëmtuarit – dëshmitarit B.M., është vërtetuar se ditën kritike kur ka ndodhur aksidenti, bashkë me tani të akuzuarin F. kanë vendosur të shkojnë për të blerë ushqim të gatshëm në qebaptore në fshatin B. dhe se deri sa tani i akuzuari ka qenë në tejkalim të autobusit ka humbur kontrollin mbi automjetin që drejtonte.

Nga provat materiale është vërtetuar se deri te aksidenti ka ardhur si pasojë e lëshimeve të ngasësit – tani të akuzuarit, i cili pa patentë shofer dhe me shpejtësi prej rreth 90 km/h, në vendin ku shpejtësia maksimale e lejuar ka qenë 50 km/h, si rrjedhojë e tejkalimit të shpejtësisë dhe pa përvojë për të drejtuar automjetin, pa patentë shofer, ka humbur kontrollin mbi automjetin, me ç’rast, me pjesën e anës së djathtë ka goditur këmbësinorin- tani të ndjerin F.K., i cili si pasojë e lëndimeve të pësuar ka vdekur në Qendrën Emergjente në Prishtinë ndërsa tani i dëmtuari B.M., i cili ka qenë në veturë si pasagjer në momentin e aksidentit ka pësuar lëndime të rënda trupore.

Edhe nga mbrojtja e të akuzuarit F.M., është vërtetuar se ai ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar dhe është deklaruar fajtorë gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor, por me mbrojtësin e tij kanë pretenduar se veprimet e tij kanë ardhur si pasojë e pakujdesisë.

Trupi gjykues, i ka vlerësuar pretendimet e mbrojtësit dhe të akuzuarit se veprimet e të akuzuarit kanë ardhur si pasojë e pakujdesisë, por ka ardhur në përfundimin se në këtë rast nuk kemi pakujdesi në kryerjen e veprave penale sepse kryesi i tyre – tani i akuzuari nuk ka qenë i pajisur me patentë shofer dhe ka ngarë automjetin me shpejtësi prej rreth 90 km/h, në vendin ku shpejtësia maksimale e lejuar ka qenë 50 km/h. Tani i akuzuari, pa patentë shofer nuk ka

pasur të drejtë ta drejtoj automjetin fare e ai këtë e ka bërë dhe ka shkaktuar aksident me pasoja fatale për tani të ndjerin F.K. dhe me lëndime të rënda për tani të dëmtuarin B.M.. Sipas trupit gjykues, pakujdesi në këtë rast do të kishte sikur tani i akuzuari të ishte i pajisur me patentë shofer, e pastaj lëshimet e tij gjatë drejtimit të automjetit të ishin shkaktarë të aksidentit.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për veprën penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtorë, trupi gjykues ka marrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarit, gjykata mori në konsideratë: rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarit; moshën e të akuzuarit në kohën e kryerjes së veprës penale, përkatësisht i njëjti me datë 24.07.2018 ka qenë akoma pa i mbushur 19 vjeç; sjellja korrekte e të akuzuarit me prokurorinë dhe gjykatën, përkatësisht i njëjti edhe pse jeton në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe, gjithnjë është paraqitur me rregull në seanca; pranimin e vazhdueshëm të veprimeve që ka ndërmarrë ditën kritike, që nga nisja me automjet nga shtëpia e deri te shkaktimi i aksidentit; keqardhjen e shprehur nga i akuzuari gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor dhe sjelljen e tij para dhe pas kryerjes së veprës penale, përkatësisht i njëjti nuk është i dënuar më parë, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka marrë parasysh intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, përkatësisht nga veprimet e tani të akuzuarit ka humbur jetën tani i ndjeri F.K. ndërsa i dëmtuari B.M. ka pësuar lëndime të rënda trupore.

Andaj, gjykata të akuzuarit i ka shqiptuar dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me dënimin e shqiptuar atij, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK, përkatësisht të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëj rehabilitimin e tyre, të parandaloi persona të tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga veprat penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, për ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Në këtë rast, gjykata është bazuar edhe në nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, për një proces të hapur dhe të rregullt, që çdo person i akuzuar ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, duke pasur parasysh edhe bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij, si dhe në parimin që çdo person i akuzuar për një vepër penale të prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

Pas shpalljes së aktgjykimit, i akuzuari është deklaruar dhe ka dhënë pëlqimin me shkrim se e pranon dënimin e shqiptuar me burgim prej gjashtë muaj për veprën penale si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe ka pranuar që ky dënim t'i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 3000 euro.

Bazuar në nenin 46 par. 2 të KPRK, është vendosur që dënimin me gjobë si më lart, i akuzuari mund ta paguaj deri në tre këste

Të dëmtuarit B.K. dhe B.M., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike nuk janë udhëzuar në kontest civil sepse gjatë shqyrtimit gjyqësor kanë heqë dorë nga kjo e drejtë, përkatësisht i dëmtuari K. ka thënë se nga i akuzuari nuk kërkon kompensim dëmi sepse këtë dëm e ka kompensuar nga Kompania e Sigurimit, ndërsa i dëmtuari M. ka thënë se është në

proces të kompensimit të dëmit nga Kompania e Sigurimit, por nga i akuzuari nuk kërkon kompensim dëmi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 450 të KPP, ndërsa vendimi mbi taksën për kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë të neneve: 3; 6 dhe 39, par .3.2 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të neneve: 378, par. 5, lidhur me par. 1 të KPRK; 378, par. 4, lidhur me par. 1 të KPRK; dhe 364, par. 1 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 12.08.2024.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/ DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.17/2020, datë 06.08.2024.

Zyrtare ligjore
Ibadete Zullufi

Kryetari i trupit gjykues
Naser Foniqi

UDHËZIMI PËR MJETET JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar **brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh**, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.